

**THE MYTH OF THE NEW MAN IN THE NOVELS *BRAVE NEW
WORLD* AND *1984***
**MITI I NJERIUT TË RI TE ROMANET *MË E MIRA E BOTËVE* DHE
*1984***

Emine SHABANI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: emine.shabani@unite.edu.mk

Abstract

The most significant tendency of the communist order, was the creation of the myth of the new man. This tendency from the first communist state tried to extend in various forms to western countries. This is best told by Georg Orwell in *Animal Farm* and *1984*, but also by Aldous Huxley in *Brave New World*. Orwell's sardonic satire in both his works and the arbitrary behavior of Big Brother and Napoleon and Snow Ball testify to a Western crypto-communism, as an appropriate way of governing the broad masses of the people. At the same time, this narrative represents the authors' vision for the future of the world, the tendency for its rule 600 years after Freud (at Huxley) and, after the Colchester nuclear war (according to Orwell in *1984*). This tendency has distanced literature from man as an individual, from a subject, due to the regulation of iconography and the codification of characters.

Keywords: *New man, myth, utopia, dystopia, the vision of the future.*

Përmbledhje

Tendenca më domethënëse e rendit komunist, ishte krijimi i mitit të njeriut të ri. Këtë tendencë nga shteti i parë komunist, u përpoqën që në forma të ndryshme ta shtrijnë edhe në vendet perëndimore. Këtë e rrëfen më së miri Georg Orwell te *Ferma e kafshëve dhe 1984*, por edhe Aldous Huxley te *Më e mira e botëve*. Satira sardonike e Orwell-it, te të dy veprat e tij dhe sjellja arbitrare e Vëllait të Madh dhe Napoleonit e Snow Ball-it e dëshmojnë një krypto komunizëm perëndimor, si mënyrë të përshtatshme qeverisjeje me masat e gjera popullore. Në të njëjtën kohë kjo mënyrë rrëfimi përfaqëson vizionin i autorëve për të ardhmen e botës, tendencën për qeverisjen e saj 600 vjet pas Frojdit (te Huxle-y) dhe, pas luftës bërthamore në Kolchester (sipas Orwell-it te *1984*). Kjo prirje e ka distancuar letërsinë nga njeriu si individ, nga subjekti, për shkak të rregullit ikonografik dhe kodifikimit të plotë të personazheve.

Fjalët kyçe: *Njeriu i ri, miti, utopia, distopia, vizioni i së ardhmes.*

Hyrje

Njeriu i ri është një nga projektet më kontradiktore në historinë politike të njerëzimit. Qëllimi i tij është të modulojë, përshtatë, kontrollojë, kodifikojë dhe programojë progresin lëndor dhe shoqëror në funksion të interesave të paracaktuara. Miti i njeriut të ri është pjesë e një skeme të njohur paradigmatiske, si ideologjia rendi, familja, morali, shoqëria, madje tendencat e zhdukjes së familjes, moralit dhe krijimit të një bote të re, prodhimin e njeriut në laboratorë (*Më e mira e botëve*). Booker thekson se edhe në tekstet utopike të Platonovit lind pyetja se sa shkenca është garanci për përparimin dhe lumturinë e një kombi (Booker 1994: 11).

Rezultatet dhe diskutimi

Romane distopike, kanë shkruar edhe Evgenij Zamjatin *Ne* dhe Andrej Platonov *Çevengur*. Mekanizmat që degjenerojnë botën në fiksionet distopike, janë të shumëllojshme nga represioni dhe izolimi deri në harresë. Zamjatin në romanin e tij *Ne*, flet për humbjen e individualitetit dhe përpjekjet e dëshpëruara për ta rikthyer atë. Platonovi në *Çevengur* shpjegon mënyrat se si vijnë në pushtet udhëheqësit dhe përpiqen të depërtojnë në mendësinë e popullit "përtej", si Sorokini në *Sallën Blu* i cili përpiqet të zbërthejë personalitetet e kultit që janë të ushqyer nga diktatorët.

Zamjatini mendon se rezistenca, mund ta ndryshojë kursin e shoqërisë distopike komuniste. Qëndrimet e personazheve të tij janë anarkiste. Personazhet e Platonit janë konformistë, mendojnë se sistemi është i drejtë, prandaj edhe vuajnë më shumë. Distopitë përfaqësojnë vizionin për të ardhmen e shoqërisë, me të cilën na paralajmërojnë këta autorë. Ata e vënë gishtin në plagë dhe, e përshkruajnë atë që është e gabuar në një shoqëri të caktuar. E tashmja e tmerrshme dhe e padurueshme, mund të përsëritet edhe në të ardhmen që e vë në qendër të subjektit të veprës së tij, Andrej Platonov te romani *Çevengur*.

Letërsia "ekziston" por është e vështirë të përcaktohet; "Letërsia" mund të hidhet poshtë nga teoria e cila më pas do të zëvendësonte problemet aktuale dhe në të ardhmen do të thjeshtonte lundrimin midis studimeve letrare. Është vetëm një teori gjetëse në përcaktimin e kritereve të përcaktuara. teoria njih një objekt ose koncept paraekzistues dhe vazhdon. për të formuluar (ose të paktën në koherencë) një përshkrim të atij objekti, teoria ndërton konceptin dhe trajtohet nga Roman Jacobson, Northrop Fry ose Wolfgang Iseri, e kështu me radhë (Koier: 4).

Në veprat e Orwellit, arti dhe politika shkrihen sepse, siç thotë vetë autori, këto dy sfera janë shumë të rëndësishme për të. Sipas teorisë postmoderne, letërsia është pashmangshmërisht e lidhur me politikën, sepse ndër parimet e postmodernizmit, është kthimi në të kaluarën historike, jo për ta arsyetuar dhe për ta mbrojtur, por për ta ironizuar, satirizuar e fshikulluar, një ose më shumë dukuri negative, në një periudhë të caktuar të historisë, të një vendi të caktuar. Orwell-i është i njohur për satirën e tij sardonike, me të cilën godet figurat udhëheqëse historike, me anë të gjetjeve të arrira artistike, si te Ferma e kafshëve, ashtu edhe te 1984. Edhe emërtimi i personazheve historike, është një figuracion i goditur artistikisht dhe estetikisht, si: Snowball, Napoleon, apo Winston Smith, Julia, etj.

Nuk ishte e vështirë t'i mbante nën kontroll. Midis tyre lëviznin gjithmonë disa agjentë të policisë, duke përhapur thashetheme të rreme dhe duke shënuar e eliminuar ata pak persona që konsideroheshin të aftë për t'u bërë të rrezikshëm; por nuk u bë asnjë përpjekje për t'i indoktrinuar me ideologjinë e Partisë. Nuk është e dëshirueshme që profesionistët të kenë ndjenja të forta politike. Gjithçka që u nevojitej ishte patriotizmi primitiv, i cili mund të përdorej kurdoherë që ishte e nevojshme për t'i bërë ata të pranonin orë më të gjata pune ose vakte më të shkurtra (Orwell: 41).

Kësaj mund t'i shtohet se miti i njeriut të ri është distopik, kur ai reduktohet në "homo animalis", një njeri dinjitar që ka të drejtë të hapë gojën vetëm kur ha... pa u marrë me politikë, ekonomi dhe me dukuritë kulturore. Policia ndërhyri shumë pak te ata. Kishte shumë krime në Londër. E gjithë bota ishte një botë hajdutësh, banditësh, prostitutash, narkomanësh dhe dallaverexhinjsh të çdo lloji; por meqë e gjithë kjo po ndodhte mes proletarëve, nuk kishte rëndësi. Në të gjitha çështjet e moralit ata u lejuan të ndiqnin kodin stërgjyshor (Orwell: 41).

Gjithashtu, te *Më e mira e botëve*, kemi një model miti të njeriut të ri. Ai është i çnjerëzuar që nga konceptimi i tij, ndryshe nga njeriu i çnjerëzuar- i dehumanizuar i Orwell-it, i cili lind normal dhe jeton një "*jetë normale*", ndërsa njeriu natyror te *Më e mira e botëve* është ekuivalenti i një të egri si John-i i egër. John-i i egër te *Më e mira e botëve* mishëron mitin e njeriut të ri. Ai ka lindur natyrshëm. Nëna e tij është Linda, dhe babai i tij është drejtori i Fertilizimit dhe Kondicionimit.

John-i është një kundërshtar i madh i eksperimenteve, që bëhen kundër natyrës së vërtetë njerëzore. Ky i ashtuquajtur "qytetërim" nuk është gjë tjetër veçse mohim dhe largim nga natyralja. Edhe biseda mes John-it dhe Mustafa Mondit është vendimtare për romanin. Ata janë njerëz postmodernë që kanë gjithçka në dorë.

"Por pse është e ndaluar?" Pyeti i Egri, i emocionuar nga takimi me një burrë që lexonte Shekspirin. Ai menjëherë harroi gjithçka tjetër, kontrollori e goditi mbi supë: nga gjërat e vjetra, edhe kur janë të bukura?, sidomos nëse janë të bukura, bukuria është tërheqëse dhe ne nuk duam që njerëzit të tërhiqen nga gjërat e vjetra. Ne duam që ata të duan gjëra të reja". (Huxley 2008: 66)

Te *Më e mira e botëve*, librat e vjetër që Mustafa Mondit i ruan në kasafortën e hekurit, janë ekuivalenti i librit të Goldstein-it, që e lexon Winston Smith me aq kuriozitet, vëmendje dhe dashuri. Ky libër përmban thelbin e veprës mbi filozofinë e jetës dhe kuptimin e saj. Vizioni i autorit, është e ardhmja, duke i tërhequr vërejtjen lexuesit, për dehumanizimin dhe egërsinë e shfrytëzimit dhe abuzimit me qeniet njerëzore, që në fakt vetëm një hulumtim psikologjik dhe psikiatrik, mund të japë përgjigje për karaktere me struktura psiko-patologjike dhe degjenerim të personalitetit të qenies njerëzore.

Eksperimentet e prodhimit të qenieve organike të kodifikuara, në laborator, janë një tregues i mirë, për këtë dehumanizim, ndërsa në anën tjetër një njeri i lindur dhe rritur normal e natyrshëm, shihet si monstër, si demode dhe përqeshet, sepse nuk është i programuar, sa do të zhvillohet, nëpër laboratorët e Mustafa Mondit. Madje ai quhet John-i i Egër dhe fundi i jetës së tij është afër, sepse, është "ndryshe" dhe "ndryshe" do të thotë, ai ka mbetur në të kaluarën, me shijet, botëkuptimin për, jetën, botën, artin, mënyrën e ushqimit, mendimin e lirë ose të ndryshëm, e sidomos ai admiron veprën e Shekspirin.

Por Helmholtz-i, përpiqet ti shpërllajë trurin, duke i thënë se vepra e Shekspirin, është e vjetër dhe arti i tij është demode, njerëzit sot duan gjëra të reja dhe jo një Othello. Bota e re kërkon teknologji të përsosur, makina të shpejta dhe jo vepra arti të vjetra e tragjedi, zyrtësi, e vuajtje, ata duan lumturi dhe këtë ua ofron kjo *Më e mira e botëve*. Kjo bisedë i jep John-it argumente për pakuptimësinë e jetës postmoderne, gri dhe të errët. Sepse, po të ishte vërtet si Othello, askush nuk do ta kuptonte dot, [...] u lejua të ishte si Othello.

"Pse jo?" "po, pse jo?" Përsëriti Helmholtz-i. Ai gjithashtu harroi realitetin e pakëndshëm të situatës dhe të tjerët e shpërfillën atë. "Pse jo?" "Sepse bota jonë nuk është e njëjtë me botën e Othello-s. Nuk mund të bësh aeroplanë pa çelik - dhe nuk mund të bësh tragjedi pa paqëndrueshmëri sociale. Tani bota është e qëndrueshme. Njerëzit janë të lumtur; ata marrin atë që duan, nuk e duan kurrë atë që nuk mund ta marrin. [...] janë të sigurt; ata nuk janë kurrë të sëmurë; ata nuk kanë frikë nga vdekja; injorojnë me lumturi e pasionin dhe pleqërinë; nuk vuajnë për nëna ose baballarë; gratë dhe fëmijët ose të dashuruarit nuk ndihen të fortë (Huxley, 2008: 95).

Demonizimi i tjetrit: Përveç demonizimit të indianëve nga britanikët, edhe vetë indianët e nënvlerësojnë veten në krahasim me kolonizatorët anglezë, siç mendon Dr. Veraswami. Në dialogun me Florin: Dr. Veraswami e admironte me pasion gjuhën angleze [...] Ai vazhdoi me shumë dëshirë, si indian, t'i përkiste një race inferiore dhe degjeneruese. Besimi i tij në drejtësinë britanike ishte aq i madh sa edhe kur i duhej të duronte fshikullimin në burg ose të shihte të varurit në litar, kthehej në shtëpi me fytyrë të nxirë, gri e të zbehur dhe kur pinte shumë uiski, zelli i tij nuk i shuhej. (Huxley 2008: 55).

Por mes anglezëve ka edhe ofendime dhe demonizime të ndërsjella, racizëm, etj. "Shoku ynë Ellis nuk e përshëndet shoqërinë e vëllait të tij arian?" "Jo, nuk e përshëndes", tha Ellis-i nuk solidarizohem, as me vëllain tim mongol, nuk më pëlqen as që zezaku të më japë votën. McGregor-i ngriu nga fjala 'e zezë', e cila ishte e rrezikshme në Indi (Huxley 2009: 41).

Kur forca dominuese "forcohet" me sukses në kurriz të popujve të nënshtruar që qëndruan pasiv dhe të heshtur gjatë kolonizimit, atëherë analiza e Eduard Said-it merret ekskluzivisht me veprimet e kolonizatorit dhe në të njëjtën mënyrë imiton në mënyrë të pandërgjegjshme çekuilibrimin kritik që do të ndodhë. Narratori merret me letërsinë, përse i përket fenomeneve historike, kulturore dhe ekonomike dhe përshkruan jetën shoqërore e ekonomike të grupeve të dobëta që mbeten "të padukshme" në tekstet postkoloniale, sepse shumica ose merren vetëm me jetën e tyre ose janë të detyruar të ndjekin të tjerë në grupin e tyre etnik. Tipizimi Veraswami përfaqëson "tjetrin" - i cili është i ndryshëm për nga raca, kultura, feja, gjuha etj.

Analiza e dehumanizimit të njeriut në romanet e Orwell-it dhe Huxley-it

Kjo është temë qendrore në romanet 1984, *Ferma e kafshëve dhe Ditët Burmeze* të Orwellit dhe *Më e mira e botëve* e Huxley-t. Këto romane fillojnë dhe përfundojnë me temën e dehumanizimit. Narratori nënkupton pyetjen nëse vartësit janë të aftë të paraqiten apo janë të dënuar të shtrembërohen përgjithmonë nga ata që i shfrytëzojnë. Një pyetje tjetër e nënkuptuar është nëse subalternët apo proletarët mund të ngrenë zërin dhe të flasin? Në romanet 1984, *Ferma e kafshëve* dhe *Më e mira e botëve*, mund të konkludohet se ata nuk kanë ku të flasin për problemet dhe përvojat e tyre. Ata që përpiqen t'i shprehin problemet në formën e teksteve letrare apo në mënyra të tjera, mbyten, terrorizohen, u shkatërrohet familja, u mbyten miqtë, shoqëria, ata bëhen ventrilociste.

Para Revolucionit ata ishin të shtypur tmerrësisht nga kapitalistët, ishin të uritur dhe fshikulluar, gratë detyroheshin të punonin në minierat e qymyrit (ato në fakt punonin ende në minierat e qymyrit) fëmijët u shitën në fabrika në moshën gjashtë vjeçare. (Orwell: 41)

Kjo nënkupton situatën para luftës atomike në Colchester, në kohën e kapitalizmit, kur proletarët çnjerëzoheshin, nënshtroheshin dhe trajtoheshin si kafshë, ndërsa në kohën e Big Brother-Vëllait të Madh", kanë të drejta" si njerëzit tjerë. Partia e dinte se prolet ishin rregulluar natyrshëm, të cilët duheshin mbajtur të bindur, si kafshët, duke zbatuar disa rregulla të thjeshta. Në fakt, shumë pak dihej për proletariatin. Nuk ishte e nevojshme të dije shumë. Ndërsa vazhdonin të punonin dhe të riprodhoheshin, aktivitetet e tjera të tyre ishin të pakuptimta. (Orwell: 41)

Mesazhi më i rëndësishëm i shkrimtarit në romanin 1984 është se totalitarizmi shkatërron gjithçka që është njerëzore, e ndershme dhe e qytetëruar në qenien njerëzore. Vetë shprehja liri është si të thuash dy plus dy është katër dhe, tregon se pamundësia për të pasur liri thelbësore shkatërron natyrën e qenies njerëzore; njeriu është i privuar nga gjithçka që i ka dhënë natyra. Big Brother dhe rrethimi i tij janë në gjendje të formojnë një racë njerëzore të çnjerëzueshme, e cila do të veprojë mekanikisht sikur njerëzit të ishin robotë.

Ka shumë metoda që përdoren në mënyrë spontane çdo ditë për të jashtëm e partisë, që nga zgjimi në mëngjes me një alarm të lartë që i çmend e trishton njerëzit çdo mëngjes, por ky është vetëm fillimi i torturave të përditshme. Në shoqërinë e Big Brother ka ndalime, si ndalimi i të pasurit jetë intime, ndalimi i shprehjes së mendimit, ndalimi i krijimtarisë, ndalimi i përdorimit të disa fjalëve, si liria etj. Punohet intensivisht për fjalorin e ri i cili do të ketë më pak fjalë dhe të gjitha ato fjalë do të simbolizojnë "lirinë" e shprehjes, të veprimit, të jetës private e të ngjashme.

Përfundimi

Të gjitha utopitë e parashikuara para Iluminizmit i kushtojnë shumë pak vëmendje këtij problemi. Në kohën e pushtetit absolut, kur transmetimi i sovranitetit ishte një çështje trashëgimie, edhe mundësia për të pasur një sundimtar të zgjedhur për urtësinë e tij ishte revolucionare. Sidoqoftë, edhe nëse sundimtari zgjidhej për inteligjencën e tij, pushteti ishte ende në duart e vetëm një personi. Mendimtarët utopikë të para-Iluminizmit nuk dukeshin të shqetësuar veçanërisht nga legjitimimi i një strukture të tillë politike.

Me sa duket, ata të gjithë besonin se njerëzit në thelb janë të mirë dhe se mençuria e vërtetë mund të çonte vetëm në qeverinë më të mirë të mundshme. Disa filozofë arsyetuan ndryshe. Për shembull, Thomas Hobbes e përmbysi këtë paradigmë. Në Leviathanin e tij (1651), Hobbes pohoi se të gjitha shoqëritë njerëzore nuk bazohen në mençuri, por në dhunë dhe abuzim, për shkak të agresivitetit thelbësor të natyrës njerëzore. (Hobbes 1651: 434).

Por, utopistët besonin me vendosmëri se qeveritë aktuale nuk ishin gjë tjetër veçse një perversion, një tjetërsim nga pozitiviteti i natyrës origjinale njerëzore. Iluminizmit besonin se të gjithë njerëzit janë të barabartë sepse të gjithë janë të pajisur me dhuntinë e arsyes (që ishte argumenti kryesor kundër fuqisë së aristokratëve). Prandaj, për të qenë legjitime, një qeveri duhej të autorizohet nga ai që Jean-Jacques Rousseau, në librin e tij me titull (*The Social Contract*, 1762), e quajti vullneti i përgjithshëm. Prandaj, synimi i çdo qeverie është të përfaqësojë këtë vullnet të përgjithshëm dhe të qeverisë sipas tij.

Këndvështrimi i Hobsit se burrat janë të dhunshëm dhe agresivë ndaj njëri-tjetrit sipas motos së famshme homo homini lupus (njeriu është ujku i njerëzve të tjerë). Thomas Hobbes, u përpoq të ndalonte këtë tendencë të dhunshme dhe vetëshkatërruese të sunduar nga një sovran, si institucion i një shoqërie me idetë e tij, në veprën Leviatani. Një nga tendencat më të rëndësishme të trillimeve moderne distopike, totalitarizmi politik, buroi nga reflektimi mbi pushtetin. Shekulli 20 karakterizohet nga revolucioni rus, lindja e regjimeve fashiste dhe naziste, shumë shkrimtarë filluan të frikësohen se një shtet i ri totalitar mund të përfundojë duke politizuar gjithnjë e më shumë jetën private të individëve.

Referencat

- [1]. Jean-Jacques Rousseau, (2014), *The Social Contract and Other Later Political Writings* (Cambridge Texts in the History of Political Thought).
- [2]. Hobbes, Thomas, (1651), *Leviathan* (Illustrated): Premium Edition Kindle Edition,
- [3]. H. David (Illustrator).
- [4]. Huxley, A. (2006), *Brave New World*, New York, Harper Perennial Modern Classics, (US)
- [5]. Huxley, A. (2009), *Island*, Harper Perennial Modern Classics. (US).
- [6]. Orwell, G. (1996), *Animal Farm*, Orlando, Signet.
- [7]. Orwell, G. (1961), *1984*. New York, Signet Classic.
- [8]. Orwell, G. (2001), *Burmese Days*, London, Penguin Classics.
- [9]. Žižek, S. (2011), *Did Somebody Say Totalitarianism?* New York, Verso.
- [10]. Edward W. Said (1979), *Orientalism*, Vintage, New York.
- [11]. Andrei Platonov (1978), *Chevengur*, Translation by Anthony Olcott, Published by Ardis Publishers,
- [12]. 2901 Heatherway, Ann Arbor, Michigan 48104.
- [13]. Zamiatin, Eugene, (1924), *We*, Authorized Translation from Russian, By Gregory Zilborg, New York, By E. P. Dutton & Company, Printed in the United States of America.